

E sigurt: përparimi do të vijë

Në radhën e studiuesve më në zë të ditëve tona për gjuhën dhe letërsinë shqipe sa vjen e spikat figura e Dr. Robert Elsie-t. I lindur në Vankuver, Kanada, rreth 40 vjet më parë, ku edhe përfundoi suksesshëm studimet universitare në gjuhësi, Dr. Elsi iu kushtua më pas me një pasion të veçantë indoevropianistikës. Studimet në këtë fushë i thelloi më tej në Universitetet e Bonit dhe të Parisit, ndërkohë që filloi të tregonte një interesim të veçantë dhe një përkushtim të rrallë për gjuhën e letërsinë shqipe. Fryt i një pune të fuqishme e pasionante në këtë lëmë janë: Leksikoni i shkrimtarëve shqiptar (anglisht), dy antologji të poezisë shqipe (gjermanisht dhe anglisht), përkthimi në gjermanisht e anglisht i Migjenit, recensione, artikuj e studime për autorët dhe letërsinë e gjuhës shqipe.

Simpatia e veçantë që tregon Dr. Elsi për vendin tonë bën që sot ta shohim atë edhe të angazhuar si përkthyes zyrtar i Qeverisë së R.F. të Gjermanisë në veprimtaritë dhe bashkëpunimin gjithnjë e më të gjerë që po vendoset midis të dy vendeve.

Para tre muajsh Dr. Elsi ndodhej në Prishtinë i ftuar në simpoziumin shkencor “Evropa dhe shqiptarët - dje dhe sot.” Gjatë kësaj veprimtarie të shënuar ai u pranua anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Patëm rastin e lumtur të bisedonim më Dr. Elsin si më poshtë.

[AA]: Do të dëshironim që figurën e Dr. Elsit ta kundronim në tri rrafshë: 1) Dr. Elsi si albanolog, 2) Dr. Elsi si studiues i kulturës dhe i letërsisë shqipe, 3) Dr. Elsi si dashamirës me gjithë zemër i Shqipërisë.

[RE]: Albanologë sot ka shumë pak. Flitet shumë në Shqipëri për albanologë të huaj, por e vërteta është se ata në botë janë sot shumë pak, dhe kjo për dy arsye kryesore. Së pari, vetëizolimi për një kohë tejet të gjatë i Shqipërisë, që krijoi vështirësi shumë të mëdha për të takuar shqiptarët, dhe, së dyti, mungesa e librave dhe e fjalorëve për të mësuar shqip.

Në Gjermani, një vend me traditë të konsoliduar në studimet albanologjike, ka sot vetëm një katedër të specializuar për studimet albanologjike dhe pikërisht në Universitetin e Munihut, ku vendin e profesorit të nderuar Martin Camaj, sot në pension, e ka zënë Prof. Wilfried Fiedler. Së bashku me Oda Buchholtz, Prof. Fiedler ka përgatitur fjalorin shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip si dhe një “Albanische Grammatik” (Gramatikë e gjuhës shqipe), mjaft e hollësishme, e cila, sipas mendimit tim, është gramatika më e mirë e gjuhës shqipe që ekziston sot. Katedra të gjuhës shqipe ka edhe në Itali (Cosenza, Palermo, Roma dhe Napoli) dhe një në Sh. Petersburg të Bashkimit Sovjetik. Studiues të gjuhës shqipe ka edhe në Poloni, etj., por katedra të studimeve albanologjike mungojnë në vende të tilla si në ShBA, Angli, Francë, etj.

Një bazë e domosdoshme dhe të shëndoshë për studimet krahasimtare indoevropianistike përbën studimi i gjuhëve të vjetra indoevropiane siç janë sanskritishtja, latinishtja,

greqishtja, lituanishtja, hetitishtja, gotishtja, sllavishtja e vjetër e keltishtja. Shqipja gjithnjë ka përbërë një problem në këtë fushë. Dhe kurrësesi nuk mund të arrihet sukses në studimin e shqipes, pa patur bazën që përmenda më lart. Duke parë zbrazëtinë që ekziston në fushën e studimeve të letërsisë shqipe, unë jam përqëndruar, dhe më duket se jam i vetëm, pikërisht në ndriçimin e plotë e të gjithanshëm të kësaj pjese të kulturës evropiane e botërore, pra të letërsisë shqipe.

[AA]: Në një intervistë të qershorit të këtij viti dhënë “Zërit të Rinisë” në Prishtinë ju shpreheni se “pasojë e izolimit të Shqipërisë është niveli i shkencës shqiptare, e cila është shkëputur nga rrjedhat e shkencës botërore.” Do të dëshironim një zgjerim të këtij pohimi në ballafaqimin me veprimtarinë e vyer të Prof. Eqrem Çabejt në këtë fushë.

[RE]: Prof. Eqrem Çabej ishte i një brezi tjetër. Ai u shkollua para socializmit. Ai mori një shkollim të gjërë e të thellë, një formim cilësor. Sot këtu rrallë gjen njerëz që punojnë në nivelin botëror dhe kjo vetëm për arsye të mungesës së kontakteve me botën e jashtme. Kjo sipas mendimit tim, përbën një krim intelektual kundër popullit shqiptar. Mund të pohohet se me vdekjen e Çabejt vdiq njëkohësisht edhe tradita e gjuhësisë shqiptare me cilësinë dhe me përmasat botërore. Kjo padyshim është humbje e madhe, dhe jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për vetë popullin shqiptar.

[AA]: A mund të na thoni shkurtimisht me çfarë problemesh ballafaqohen sot studimet albanologjike dhe çfarë shtron sot gjuha shqipe para studimeve krahasimtare indoevropiane?

[RE]: Ndërkohë që, nëpërmjet sanskritishtes, greqishtes së vjetër e latinishtes mund të ndriçohet historia e gjuhëve indoevropiane, kur i futemi gjuhës shqipe ballafaqohemi menjëherë me një mjegull, pra nuk mund të hyjmë thellë në histori.

Kjo nuk lidhet me mungesën e ekspertëve, pra të gjuhëtarëve, por për disa arsye objektive. Mungesa e dokumenteve është në arsye, por jo gjithshka. Edhe lituanishtja është e dokumentuar në një kohë me shqipen, por kjo gjuhë e tregon historinë e vet, kurse shqipja nuk tregon gjë. Nga pikëpamja e historisë së gjuhës, shqipja është gjuha më e vështirë ndër gjuhët indoevropiane.

Sipas mendimit tim, gjuha shqipe është në gjuhë shumë eklektike. Ajo u është nënshtruar ndikimeve të shumta të ndryshme gjatë historisë së saj (arsye gjuhësore të brendshme). Gjuha shqipe është sulmuar shumë herë, dhe gati u vra, por si për mrekulli ajo mbijetoi. U plagos për vdekje nga latinishtja, por shpëtoi. u plagos rishtas për vdekje, këtë herë nga italishtja. Përsëri mbijetoi. Së fundi, iu desh të përballonte edhe plagët e sulmin e furishëm të turqishtes. Dhe prapë ia doli mbanë e mbijetoi.

[AA]: Dr. Elsi, është bërë e njohur se ju po përgatitni një punim shumë serioz për historinë e letërsisë shqipe. Do të ishte me interes nëse mund të mësonim diçka me shumë.

[RE]: Po përpiqem të shkruaj një histori sa më të plotë të letërsisë shqipe. Kjo histori letërsie do të përfshijë edhe periudhën e përparshme, por do të hyjnë në të edhe historia e letërsisë shqipe në Kosovë, letrat e shqiptarëve në Itali (arbëreshët) si dhe prodhimi letrar i diasporës, kudoqoftë. Historitë e letërsisë shqipe të shkruara deri më sot janë të pjesshme. Aty trajtohet prodhimi letrar vetëm në Shqipëri ose edhe i arbëreshëve, duke lënë jashtë fokusit letërsinë shqipe në Kosovë. Arsyet për mua janë të pakuptueshme...

[AA]: Ose krejtësisht të kuptueshme...?

[RE]: Të pakuptueshme nga pikëpamja shkencore. Pra, një histori e plotë e letërsisë shqipe sot nuk ekziston. Historia e Letërsisë Shqipe, botuar nga Akademia e Shkencave, është një vepër e dobët e skematike që falsifikon shumë vlera letrare si dhe errëson traditën. Shumë autorë janë lënë mënjanë për arsye politike, të tjerë janë nënvleftësuar për arsye politike, ideologjike e nacionaliste.

[AA]: Kemi mësuar gjithashtu se ju jeni nismëtar i një shoqate për organizimin e një fushate ndihmash humanitare nga Gjermania për vendin tonë. Ju lutem, diçka më të hollësishme në këtë drejtim.

[RE]: Kemi krijuar një organizatë humanitare e cila quhet “Evropianët për Shqipërinë.” Ne nisemi nga mendimi se Shqipëria është pjesë e Evropës dhe është detyra e popujve të Evropës për ta ndihmuar Shqipërinë, pikërisht në këto kohë të vështira, kur, pas 50 vjetësh diktature, Shqipëria ndodhet sot në pozitën e një Kalkute të Evropës. Megjithatë, do të doja të theksoja se ndihma humanitare nga jashtë është vetëm një pikë uji në det. Prandaj, ajo nuk do të mjaftojë. Në fund të fundit, është vetë populli shqiptar që duhet të ndihmojë vetveten.

[AA]: Së fundi, me gjykimin e ftohtë të shkencëtarit dhe me syrin e ëmbël të dashamirësit, si e shikoni ju, Dr. Elsi, të ardhmen e Shqipërisë?

[RE]: Mendoj se Shqipëria si pjesë e Evropës dhe shqiptarët si një popull i gjallë e i emancipuar, do të veprojnë një ditë si evropianët. Shqipëria është e rrethuar nga pasuri. E kam fjalën për pasuritë financiare, pasuritë shpirtërore dhe pasuritë intelektuale që Kontinenti i Vjetër disponon. Pasuria është një çikë si uji. Ku ka një vrimë, ajo do të futet. Deri tani shqiptarët kanë ngritur mure shumë të lartë rreth vetes. Por tani, kur muret e izolimit u rrëzuan, detyrimisht kjo pasuri, që unë e krahasova me ujin, do të rrjedhë dhe do të hyjë patjetër në vendin e bukur të shqiptarëve të mrekullueshëm.

Me çfarë shpejtësie do të ndodhë, kjo varet nga shumë faktorë që unë, kuptohet, nuk mund t’i përcaktoj. Por një gjë është e sigurtë, kjo do të vijë.

Bisedon Agron Alibali.

[botuar në / published in: gazeta *Bashkimi*, Tirana, 12 tetor/October 1991.]